



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 2556 Prot.

Vlorë, më 28/08/2025

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i sekuestros)



DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Departamenti Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse

• Drejtorisë së Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të një akti administrativ – Vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore (vendimi i sekuestros) si vijon :

• Nr.1638/4 Prot., datë 20/08/2025, i materializuar për subjektin “Albanian Shoes Cooperation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, me seli në Tiranë (Kamëz, Rruga "Rilindja", Nr. Pasurie 61/27).


Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit të lartcituuar - gjithsej 2 (dy) fletë.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të aktit të lartcituuar.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Vlorë, më 20/08/2025

Nr.1638/4 Prot.

V E N D I M

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti “Albanian Shoes Cooperation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, me seli në Kamëz, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.74, me Nr.1638/1 Prot., datë 19/06/2025, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “Albanian Shoes Cooperation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, me seli në Kamëz (Rruga Rilindja, Nr.Pasurie 61/27, Nr.Telefoni 068 6063988), me administrator z.Robert Mici, me status në QKB “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Albanian Shoes Cooperation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.1638/2 Prot., datë 20/06/2025, me lëndë “Njoftim Vendimi”. Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me njoftimin elektronik të vendimit, me email-in e datës 18/07/2025, ora 08:59, me lëndë “Njoftim Vendim”, me lajmërimin publik, si dhe me shkresën Nr.1638/3 Prot., datë 12/08/2025, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka rikërkuar subjektit debitor ekzekutimin vullnetar edhe të aktit administrativ të lartcitur.

Personi juridik debitor “Albanian Shoes Cooperation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.74, me Nr.1638/1 Prot., datë 19/06/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.74, me Nr.1638/1 Prot., datë 19/06/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Albanian Shoes Cooperation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë

03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *“Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”*,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor Nr.74, me Nr.1638/1 Prot., datë 19/06/2025, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj